



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.01.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.01.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EUROFAMIS" për aktivitetin: <"Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik prapa sheshit "Zahir Pajaziti"> dhe me numër të prokurimit: 616 -18-6909-521 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "EUROFAMIS" e datës 28.01.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit <"Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik prapa sheshit "Zahir Pajaziti">, me nr.616 18 6909 521 dhe numër të brendshëm 616 18 114 521 kundër Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK --së, të datës 24.01.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. ANULOHET Njoftimi i Vendimit për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 24.01.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "EUROFAMIS" me datë 28.01.2019 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: <"Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik prapa sheshit "Zahir Pajaziti"> me Nr.616 18 6909 521 Nr. Brendshëm 616 18 114 521". Autoriteti Kontraktues, me datë 29.01.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimet për shkeljen e nenit 59 janë të bazuara, pasi që komisioni nuk ka respektuar kërkesat e dosjes gjatë vlerësimit, respektivisht nuk ka respektuar kërkesat që kanë të bëjnë me dëshmitë e kërkuara për paisje dhe ka propozuar për dhënje të kontratës tenderuesin që nuk ka sjell dëshmi valide të kërkuara;

2.Pretendimet për shkeljen e kërkesave për dëshmitë ekonomike financiare janë pjesërisht të bazuara, pasi që sipas interpretimit të KRPP-së dhe të vendimeve të OSHP-së në mungesë të Deklaratës tatimore duhet të pranohen dëshmitë tjera e që në këtë rast është raporti i bankës;

3.Pretendimi se nuk janë dorëzuar dëshmi valide për mjete është e qëndrueshme dhe është cekur në pikën 1 të Arsyetimit;

4.Pretendimi se nuk është respektuar neni 72 është poashtu i bazuar, pasi që dëshmia (marrëveshja) e dorëzuar nga tenderuesi është e datës 21.01.2019 e që d.t.th.se është një dokument që nuk e ka ekzistencën para, por pas dorëzimit të tenderit; dhe

5.Pretendimi për mosverifikimin e vërtetimit tatimor, respektivisht për pranimin e dokumentit të falsifikuar është plotësisht i bazuar, pasi që vërtetimi tatimor për anëtarin e konzorciumit "Noti Beton" SHPK është i falsifikuar. Kjo vërtetohet me faktin se ai vërtetim është dorëzuar si vërtetim i datës 15.10.2018, ndërsa nga faqja zyrtare e ATK-së vërtetohet se i njëjti është lëshuar me datë 01.06.2018.

Bazuar në sqarimet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të Vendimit dhe ky aktivitet duhet të kthehet në rivlerësim nga një komision i ri, anëtarët e të cilit duhet të propozohen menjëherë nga Njësia e Kërkesës-DIKMK-ja.

Lidhur me lëshimet e komisionit do të njoftohet Kryetari i Komunës dhe është në kompetencën e të njëjtit trajtimi i tyre.

Zyrtari i prokurimit që ka menaxhuar këtë aktivitet obligohet që të përgatis kërkesën për Organin Shqyrtues të Prokurimit për futjen në listën e zezë të OE-ik (grupit të OE-ik) për falsifikim të dokumentacionit.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese;
- Njesisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit; dhe
- Anëtarëve të komisionit